



**Studimi Matës i Nivelit të Funksionalitetit dhe Demokratizimit të Brendshëm  
të Qeverisë së Nxënësve**

**Tetor 2021**

Hartimi i metodologjisë dhe përgatitja e raportit:

Znj. Anda Kruetani, Eksperte/  
Asistente Projekti, KShH

Redaktimi:

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore  
Ekzekutive, KShH

Znj. Roven Vuksani, Koordinatore  
Projekti, KShH

Z. Daniel Prroni, Koordinator  
Projekti, KShH

Publikuar nga:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rruga “Brigada e VIII,, Kulla  
“Tekno Projekt,,, Shkalla 2,  
Apartamenti 10, Kati 6

**©2021 Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Të gjitha të drejtat e rezervuara.**

Ky raport u hartua në kuadër të projektit “Konsolidimi i Qëndrueshmërisë Komunitare ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm duke fuqizuar Rininë” mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë te autor-it/ve dhe nuk përfaqesojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

## **Përmbajtja**

|                                                                                                                                                             |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. Hyrje.....                                                                                                                                               | 4  |
| 2. <u>Përmbledhje Ekzekutive</u> .....                                                                                                                      | 5  |
| 3. Metodologjia.....                                                                                                                                        | 6  |
| 4. Kuadri rregullator për organizimin dhe funksionimin e Qeverisë së Nxënësve.....                                                                          | 7  |
| 5. Njohuritë dhe vlerësimi i trupës studentore mbi aktivitetin e Qeverisë së Nxënësve si dhe angazhimi në përzgjedhjen e ndërvperimin me përfaqësuesit..... | 9  |
| 6. Njohuritë dhe vlerësimi i anëtarëve të Qeverisë së Nxënësve mbi aktivitetin dhe angazhimin e Qeverisë .....                                              | 19 |
| 7. Rekomandime.....                                                                                                                                         | 31 |

## 1. Hyrje

Në përputhje me misionin e tij, për respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) angazhohet gjerësisht në edukimin e brezave të rinj të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë mbi liritë themelore të njeriut, shtetin e së drejtës, si dhe demokracinë e demokratizimin e mëtejshëm të të gjitha strukturave qeverisëse, duke përfshirë këtu edhe modelet në institucionet edukuese sicc janë edhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Në kuadër të këtij objekti, Komiteti Shqiptar i Helsinkit zbatoi nismën “Konsolidimi i Qëndrueshmërisë Komunitare ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm duke fuqizuar Rininë” mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, një komponent i së cilës është realizimi i një Studimi Matës të Nivelit të Funksionalitetit dhe Demokratizimit të Brendshëm të Qeverisë së Nxënësve në shkollat e mesme me fokus kryesor në pesë qytete në vend: Gjirokastrë, Durrës, Librazhd, Burrel, and Rreshen. Studimi synon të vlerësojë disa aspekte të funksionimit të Qeverisë së Nxënësve: mënyrën e përzgjedhjes së saj, mënyrën e angazhimit, ndërvlerimit e Qeverisë me aktorë të tjerë (drejtorja, mësuesit, nxënësit, etj.) dhe zhvillimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare dhe detyrave të tjera të parashikuara për këto organe. Detyrat kryesore të veprimtarisë së Qeverisë së Nxënësve janë parashikuar në Udhëzimin Nr. 28, datë 02.08.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisë së Nxënësve“. Në zbatim të këtij udhëzimit të Ministrisë së Edukimit, çdo shkollë duhet, me nismën e saj, të ndërtojë trupën e vet të përfaqësimit të nxënësve.

Deri më sot, të dhënat lidhur me funksionalitetin e Qeverisë së Nxënësve në arsimin parauniversitar në Shqipëri mungojnë, sidomos kur bëhet fjalë për veprimtarinë dhe aktivizmin e tyre për zhvillimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare të cilat konsiderohen si kycce për jetën shkollore të nxënësve në shkollat e mesme. Për këtë arsye, matja e aspekteve të përmendura më sipër do të shërbejë si një bazë e qëndrueshme për t’u përdorur në vijim me qëllim inkurajimin e mëtejshëm dhe fuqizimin e të rinjve për t’i bërë struktura të tilla të funksionojnë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dëshiron të falenderojë të gjithë aktorët që kanë kontribuar në përgatitjen e këtij raporti studimor, veçanërisht Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendrën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, shkollat e mesme me të cilat kemi bashkëpunuar përgjatë zbatimit të kësaj nisme – „Ibrahim Muca“, Librazhd, „Kajo Karafili“, Maminas, Shkolla e Mesme e Përgjithshme Rreshen, „28 Nëntori“, Burrel dhe „Asim Zeneli“, si dhe Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Tiranë për bashkëpunimin shumë të mirë që kemi patur ndër vite në zbatimin e nismave të rëndësishme për fuqizimin e të rinjve në vendin tonë, si dhe për mbështetjen që bëri të mundur realizimin e këtij raporti.

## 2. Përmbledhje Ekzekutive

Miratimi i Udhëzimit Nr. 28, datë 02.08.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisë së Nxënësve” përbën një zhvillim të rëndësishëm për ngritjen dhe veprimtarinë e strukturave përfaqësuese të nxënësve në institucionet e arsimit parauniversitar. Ndaj është e rëndësishme të kuptohet niveli i zbatimit efektivisht i këtij udhëzimi dhe nxitja e përmirësimit të funksionalitetit të këtyre strukturave në shkollat e mesme në vend.

Të dhënat e marra nga Studimi Matës i Funksionalitetit dhe Demokratizimit të Brendshëm të Qeverisë së Nxënësve reflektojnë një situatë të qëndrueshme sa i takon periodicitetit të zgjedhjeve dhe zgjedhjes së përfaqësuesve rregullisht, në përputhje me parashikimet në Udhëzimin Nr. 28, datë 02.08.2013.

Nga analiza e të dhënave të anketimit rezulton se praktika e mirëformuar nuk shtrihet në tërësi të metodave të zhvillimit të zgjedhjeve: si hedhja e kandidaturave, realizimi i fushatave, zgjedhja me votë të fshehtë, zgjedhja e Kryetarit/es dhe posteve të tjera të Qeverisë. Në disa raste, vihen re ndërhyrje problematike nga ana e mësuesve përgjegjës dhe kujdestarë të klasave si në procesin e kandidaturave dhe, në një rast specifik, deri në përzgjedhjen e përfaqësuesit/es së drejtpërdrejtë të klasës.

Ndërkohë që komunikimet informale të vendimeve dhe diskutimeve të Qeverisë së Nxënësve për pjesën tjetër të nxënësve realizohen nëpërmjet përfaqësuesve të klasës, takimet periodike dhe afishimet e këtyre komunikimeve vlerësohet të jenë të rralla dhe jo të mirëorganizuara. Për këtë arsye, vlerësohet se ushtrimi i demokracisë së drejtpërdrejtë në shkolla është më pak funksional se sa ai i demokracisë përfaqësuese. Vlerësohet e nevojshme që nxënësit të edukohen dhe për format e tjera të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të tyre duke e parë ambientin shkollor si një hap të rëndësishëm paraprak për ushtrimin e demokracisë si qytetarë votues të ardhshëm të Republikës së Shqipërisë.

Ndërveprimet e Qeverisë së Nxënësve me përfaqësuesit e drejtorisë dhe mësuesit vlerësohet të jenë të qenësishme dhe në pjesën më të madhe të rasteve, ndjekin parashikimet e Udhëzimit, por vlerësohet e domosdoshme që Qeveria dhe nxënësit të kenë një fushëveprim dhe peshë më të madhe në hartimin e dokumentave udhëheqës të punës së tyre vjetore. Pavarësisht se në nivele më të ulëta krahasuar me strukturat e tjera, rezulton se Qeveria e Nxënësve ndërvepron edhe me organizata jofitimprurëse sidomos me ato të cilat zbatojnë projekte të ndryshme në komunitet.

Së fundmi, vihet re një angazhim i kënaqshëm i Qeverisë së Nxënësve në zhvillimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare, kryesisht gjatë festave kombëtare/ndërkombëtare, por dhe me program sensibilizues. Gjithashtu, evidentohet ndërveprim i Qeverisë me nxënësit e tjerë në zhvillimin e këtyre aktiviteteve, si dhe, në një rast, pjesëmarrje e nxënësve në mbledhje të Qeverisë në raport me aktivitetet e kryera. Praktika të tilla të mira sugjerohet të shtrihen dhe më

tej; si në institucione të tjera të arsimimit, ashtu dhe në aspekte të tjera për të zhvilluar një ndërveprim më të plotë midis Qeverisë dhe nxënësve.

### **3. Metodologjia**

Të dhënat e Raportit të Vlerësimit të Funkcionalitetit dhe Demokratizimit të Brendshëm të Qeverisë së Nxënësve janë marrë nëpërmjet metodës së anketimit duke u bazuar në dy pyetësorë të hartuar. Njëri prej pyetësorëve targeton anëtarët e Qeverisë së Nxënësve dhe pyetësori i dytë targeton drejtpërdrejtë pjesën tjetër të trupës studentore për të mbledhur kampion të plotë mbi njohuritë e përfshirjen e nxënësve në aktivitetet e ndryshme të Qeverisë, qoftë këto planifikime projektesh/aktivitetesh jashtëshkollore apo aktivitete të brendshme të Qeverisë, të cilat diktohen nga Udhëzimi Nr. 28, datë 02.08.2013.

Pas finalizimit të metodologjisë, pyetësori është shpërndarë tek nxënësit e pesë shkollave të mesme pjesëmarrëse në projekt: Shkolla e Mesme e Përgjithshme Rrëshen; Shkolla e Mesme “Ibrahim Muça,, Librazhd; Shkolla e Mesme “Kajo Karafili,, Maminas; Shkolla e Mesme “28 Nëntori,, Burrel dhe; Shkolla e Mesme “Asim Zeneli,, Gjirokastrë.

Mbledhja e përgjigjeve të anketimit u realizua gjatë muajit Tetor 2021 ku pyetësori është shpërndarë fizikisht nga ana e stafit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit të angazhuar në hartimin e metodologjisë dhe në zbatimin e projektit.

Në përfundim të anketimit u bë e mundur marrja e të dhënave nga 297 nxënës, prej të cilëve 40 ishin përgjigje të marra nga pjesëtarë të Qeverisë së Nxënësve dhe 257 nga pjesa tjetër e trupit studentor. Plotësimi i pyetësorëve është realizuar në mënyrë anonime dhe duke ka shmangur çdo pyetje që cënonte të dhëna personale të kampionit në fjalë.

Mbetet e nevojshme për t’u theksuar se kampioni i përzgjedhur përfshin thuajse çdo pjesëtar të Qeverisë së Nxënësve të 5 gjimnazeve të përfshirë në projekt dhe një paralele prej secilës prej tre klasave përbërëse të sistemit të mesëm të lartë të shkollimit në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, është e nevojshme të theksohet se pavarësisht se ky kampion përfaqëson në një mënyrë cilësore gjimnazet në fjalë, një vlerësim i tillë duhet të zgjerohet më tej për të ofruar një panoramë të plotë sa i takon funksionimit të Qeverive të Nxënësve në të gjithë sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Pyetësori për Qeverinë e Nxënësve përmban 33 pyetje dhe ai për nxënësit 26 pyetje. Pjesa më e madhe e pyetjeve janë strukturuar për të zgjedhur një përgjigje mes alternativave të ofruara dhe u përpunuan në formë statistikore nga ekspertët hartues të raportit. Pjesa e mbetur e pyetjeve të hapura u përpunuan në mënyrë cilësore. Në tërësi, sondazhi është strukturuar duke u përqëndruar në tri tema:

1. Mënyra e përzgjedhjes së nxënësve përfaqësues dhe funksionimi i Qeverisë së Nxënësve;
2. Ndërveprimi mes Qeverisë dhe aktorëve të tjerë; dhe

3. Zhvillimi i aktiviteteve ekstrakurrikulare (jashtë programit të shkollës) dhe plotësimi i detyrave nga Qeveria e Nxënësve

#### **4. Kuadri rregullator për organizimin dhe funksionimin e Qeverisë së Nxënësve**

Parashikimet për ngritjen dhe aktivitetin e Qeverisë së Nxënësve janë kryer në tërësi nëpërmjet Udhëzimit Nr. 28, datë 02.08.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisë së Nxënësve,, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave. Sipas pikës 1 të Udhëzimit, ngritja e Qeverisë në çdo shkollë, qoftë kjo e ciklit të ulët apo të mesëm, i takon vetë nxënësve të shkollës. Për të zhvilluar një analizë të qënësishme të mënyrës së ngritjes dhe funksionalitetit konkret të Qeverive të Nxënësve në 5 gjimnazet e Republikës së Shqipërisë të targetuara nga kjo nisëm është e nevojshme që fillimisht të parashirohen parashikimet e dokumentave politikë të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit sa i takon trajtimit të kësaj çështjeje.

Së pari, çdo shkollë, pavarësisht numrit të nxënësve dhe paraleleve të klasave, formon Qeverinë e saj të Nxënësve, nëpërmjet zgjedhjeve të kryera në fillim të secilit vit mësimor. Në shkollat 9-vjeçare, përfaqësues zgjidhen vetëm nga klasat 6-9, kurse në ato fillore nga klasat 4-6, duke plotësuar kështu rregullin e mësipërm. Zgjedhjet zhvillohen sipas klasave nëpërmjet formatit:

- a) Kur një klasë ka vetëm një deri në katër paralele, nxënësit, nën kujdesin e mësuesve kudjestarë përkatës, zgjedhin për çdo klasë paralele nga një anëtar të qeverisë së nxënësve;
- b) Kur një klasë ka më shumë se katër paralele, çdo klasë paralele, nën kujdesin e mësuesit kudjestar përkatës, zgjedh me shumicë votash tre nxënës, të cilët formojnë së bashku përfaqësuesit e paraleleve të një klase. Përfaqësuesit e paraleleve të një klase, nën kujdesin e një mësuesi të caktuar nga drejtori, zgjedhin me shumicë të thjeshtë votash të fshehta, katër anëtarë të qeverisë së nxënësve.

Kryetari i Qeverisë së Nxënësve në shkollat e mesme zgjidhet ndërmjet anëtarëve të Qeverisë së Nxënësve, me votë të drejtpërdrejtë të nxënësve të shkollës me konkurimin e të paktën dy kandidatëve. Në mbledhjen e parë të Qeverisë së Nxënësve zgjidhet nënkryetari dhe sekretari i Qeverisë. Anëtarët e Qeverisë mbulojnë aspekte të caktuara të veprimtarive të shkollës.

Misionet bazë për t’u plotësuar nga Qeveria e Nxënësve janë:

- a) të mbrojnë dhe të promovojë të drejtat e nxënësve;
- b) të kontribuojë në plotësimin dhe zhvillimin e interesave të nxënësve;
- c) të ndihmojnë në mbarëvajtjen e shkollës;
- d) të përfaqësojnë nxënësit e shkollës në marrëdhëniet me drejtorinë e shkollës, komunitetin dhe nxënësit e shkollave të tjera.

Mënyra e funksionimit të saj detajohet në legjislacionin në fuqi, rregulloren e brendshme të shkollës dhe në rregulloren e vetë Qeverisë së Nxënësve. Kjo e fundit hartohet nga grupe pune të formuara nga nxënës dhe miratohet nga Qeveria, pas marrjes së pëlqimit nga bordi dhe drejtori i shkollës.

Udhëzimi gjithashtu parashikon të drejtat dhe detyrat e Qeverisë së Nxënësve. Qeveria e nxënësve ka të drejtë:

- a) të parashtojë shqetësimet e saj për mbrojtjen e të drejtave të nxënësve të shkollës dhe propozimet për mbarrëvajtjen e shkollës te drejtori i shkollës, këshilli i mësuesve, këshilli i prindërve dhe bordi i shkollës;
- b) të ketë një vend në shkollë ku të afishojë lajmërimet e veta;
- c) të botojë gazetën e qeverisë së nxënësve;
- d) të bashkëpunojë me qeveri homologe nxënësish për organizimin e veprimtarive të përbashkëta;
- e) t'i drejtohet komisionit të etikës dhe sjelljes të shkollës dhe çdo organizmi tjetër për çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund të shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral tek nxënësit në mjediset e shkollës.

Ndërkohë për Qeverinë e nxënësve janë parashikuar edhe detyrat përkatëse si në vijim:

- a) të organizojë veprimtari nëpërmjet të cilave nxënësve u jepet mundësia të dëgjohen nga drejtuesit dhe mësuesit e shkollës për idetë në të mirë të tyre dhe të shkollës;
- b) të organizojë veprimtari të nxënësve në dobi të shkollës;
- c) të kontribuojë në krijimin e një klime pozitive në shkollë, veçanërisht në zgjidhjen e konflikteve nxënës-nxënës, nxënës-mësues;
- d) të kontribuojë në parandalimin dhe pakësimin e abuzimit të nxënësve me duhanin, alkoolin dhe drogat, si dhe të braktisjes së shkollës;
- e) të organizojë ndihmë ndaj nxënësve me vështirësi në të nxënë ose me probleme sociale.

Më tutje, Qeveria është gjithashtu përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planit të saj vjetor në bashkëpunim me nxënës të shkollës dhe përgatitjen e raportit vjetor të veprimtarisë së saj, të cilën ia dërgon drejtorisë, kryetarit të bordit dhe kryetarit të këshillit të prindërve. Raporti në fjalë duhet të jetë i aksesueshëm edhe nga nxënësit e shkollës.

Qeveria e Nxënësve është struktura që ka përgjegjësinë për të marrë nismën për të zhvilluar veprimtari jashtëkurrikulare jopolitike të nxënësve dhe i organizon ato në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës; për të përgatitur dhe realizuar projekte (në bashkëpunim me drejtorinë) me qëllimin plotësimin dhe zhvillimin e interesave të nxënësve; për të zhvilluar pyetësorë mbi kënaqësinë e nxënësve për shërbimin që shkolla siguron ose për aspekte të veçanta të jetës shkollore të nxënësve; botuar gazetën e qeverisë së nxënësve të shkollës. Nxënësit informohen rregullisht nga Qeveria për veprimtaritë e planifikuara, kurse, në mbledhjet e organizmit ftohen



përfaqësues të bordit të shkollës, drejtorisë, këshillit të prindërve të shkollës, mësues dhe përfaqësues të OJF-ve.

Në përmbushjen e detyrave të saj Qeveria e Nxënësve bashkëpunon me drejtorin e shkollës dhe me mësuesin ndihmës. Këto marrëdhënie janë gjithashtu të parashikuara në Udhëzimin e mësipërm. Qeveria e Nxënësve ka lirinë të përzgjedhë mësuesin ndihmës, i cili emërohet nga drejtori i shkollës dhe ka detyrën të ndihmojë Qeverinë “në hartimin dhe zbatimin e veprimtarive të saj dhe, në veçanti, në hartimin e rregullores së qeverisë së nxënësve,, Nëse Qeveria vlerëson se mësuesi ndihmës nuk plotëson detyrat e tij, Qeveria ka lirinë të kërkojë zëvendësimin e mësuesit ndihmës, të cilit, si rregull, nuk i jepet klasë në kujdestari, përveç rasteve të veçanta.

Ndërkohë, drejtori i shkollës ka për detyrë në raport me Qeverinë e Nxënësve, që:

- a) t'i vërë në dispozicion dokumentat zyrtare që kanë të bëjnë me veprimtarinë e saj dhe të shkollës, si ligji për sistemin arsimor parauniversitar, Dispozitat Normative dhe akte të tjera nënligjore;
- b) të takojë një herë në dy muaj qeverinë për të degjuar shqetësimet dhe propozimet e saj;
- c) t'i sigurojë qeverisë një mjedis ku të zhvillojë veprimtaritë e saj, të ruajë arkivën e saj dhe të caktojë një vend ku qeveria e nxënësve të afishojë lajmërimet;
- d) të përfshijë përfaqësues të qeverisë në grupet e punës që hartojnë rregulloren e shkollës, planin afatmesëm dhe planin e saj vjetor;
- e) të ftojë kryetarin në mbledhje të këshillit të mësuesve, kur shqyrtohen çështje që kanë të bëjnë me kontributin e qeverisë së nxënësve,, Qeveria ka detyrën të kërkojë leje me shkrim nga drejtori për veprimtaritë jashtëkurrikulare që organizon në mjediset e shkollës dhe jashtë tij.


## **5. Njohuritë dhe vlerësimi i trupës studentore mbi aktivitetin e Qeverisë së Nxënësve si dhe angazhimi në përzgjedhjen e ndërvperimin me përfaqësuesit**

### **Të dhëna të përgjithshme mbi të anketuarit**

Të dhënat e kategorizuara për nxënësit që i janë përgjigjur anketimit, pasqyrohen në vijimësi:

#### **a. Gjinia**


59.5% e të anketuarëve e ose 153 prej tyre ishin vajza, ndërsa 40.5% ose 104 përgjigje erdhën nga djem.



## b. Moshë


Të dhënat e kategorizuara sipas moshës së të anketuarve evidentojnë se pjesa më e madhe e tyre i përket grupmoshës 15-18 vjeç ndërkohë që:

- 0.8% e të anketuarëve i përkisnin moshës 14 vjeç (2 individë)
- 27.7% e të anketuarëve ishin 15 vjeç (71 individë)
- 31.6% e të anketuarëve bënë pjesë në grupmoshën 16 vjeç (81 individë)
- 33.2% e të anketuarëve ishin 17 vjeç (85 individë)
- 5.9% e të anketuarëve i përkisnin moshës 18 vjeç (18 individë)
- 0.4% e të anketuarëve ishin 19 vjeç (1 individ)
- 0.4% e të anketuarëve i përkisni grupmoshës 20+ (1 individ)



## c. Klasa

Lidhur me kategorizimin sipas klasave, të anketuarit ndahen në tre grupe kryesore ku:




- 36% e të anketuarëve ishin nxënës në klasën e 10 (91 individë)
- 32.4% e të anketuarëve ishin nxënës në klasën e 11 (82 individë)
- 31.6% e të anketuarëve ishin nxënës në klasën e 12 (80 individë)

Shpërndarja thuajse e barabartë midis kampioneve në klasa reflekton mënyrën e përzgjedhjes së kampionit në çdo shkollë duke u bazuar në metodologjinë e

hartuar.


## d. Qyteti/Shkolla

Sa i takon shkollës ku shkollohen nxënësit e anketuar, shumica prej tyre përfaqëson Shkollën e Mesme “Ibrahim Muça,, Librazhd (68 individë) ose 26.7% e të anketuarve,



ndjekur nga 23.5% e të anketuarëve të cilët shkollohën pranë Shkollës së Mesme “Asim Zeneli,, Gjirokastër (60 individë). 21.2% e të anketuarëve ndiqnin shkollimin pranë Shkollës së Mesme Rrëshen (54 individë) ndërsa pjesa tjetër e të anketuarve ndahet më Shkollës së Mesme “Kajo Karafili,, Maminas (19.6%) dhe Shkollës së Mesme “28 Nëntori,, Burrel (9%).

## Vlerësimi i të anketuarëve mbi situatën



### a. Mënyra e përzgjedhjes së nxënësve përfaqësues në Qeverinë e Nxënësve


Për të krijuar bazën mbi të cilën do të ndërtohet informacioni, nxënësit fillimisht u pyetën nëse Qeveria e Nxënësve ishte krijuar në shkollën ku ata ndjekin mësimin, duke mbajtur parasysh që mbledhja e përgjigjeve është kryer më se një muaj pas fillimit të vitit shkollor. 66.1% e të anketuarve u përgjigjën se Qeveria e Nxënësve ishte ngritur, 6.5% pohuan se Qeveria e Nxënësve nuk ishte ngritur dhe 27.3% nuk kishin dijeni lidhur me këtë çështje.

Vetëm 59 nga 162 nxënësit që u përgjigjën se Qeveria e Nxënësve në shkollën e tyre ishte ngritur, kishin dijeni për numrin e përfaqësuesëve në këtë organ. Megjithatë, nisur nga përgjigjet e nxënësve të së njëjtës shkollë, vihet re se ka një mungesë koherence për një informacion të tillë pasi nxënës të ndryshëm kanë ofruar alternativa të ndryshme për numrin e anëtarëve të Qeverisë së Nxënësve. Nga të dhënat në dispozicion është lehtësisht e dukshme që nxënësit e shkollave nuk kanë njohuri shumë të mira mbi formimin ekzistues të Qeverisë dhe nuk arrijnë t’i njohin të gjithë përfaqësuesit.

Shumica e nxënësve (118 nxënës) pohojnë se përfaqësuesit e tyre (senatorët e klasës) zgjidhen nëpërmjet votës së nxënësve të klasës. Megjithatë vetëm një pjesë e vogël evidenton se, përpara procesit të votimit, kandidatët zhvillojnë fushatat e tyre për të marrë vota (11 nxënës). Zhvillimi i fushatës njihet si një mekanizëm pozitiv për t’u mësuar nxënësve mbi demokracinë dhe mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve me standarte demokratike, lirinë e të zgjedhurit, etj., një element shumë i rëndësishëm duke patur parasysh se ata nxënës do të jenë votues në zgjedhje parlamentare apo vendore brenda një kohe të shkurtër. Nga ana tjetër, një pjesë e të anketuarve (konkretisht 33 prej tyre) reflekton një fenomen problematik ku mësuesit ndikojnë në zgjedhjet e nxënësve duke vendosur kriteret e caktuara të cilët penalizojnë një pjesë të nxënësve nga kandidimi i lirë. Në





shumicën e rasteve, kriteri bazë që referohet prej nxënësve është mesatarja, ku një prej tyre shprehet se “mesatarja duhet të jetë mbi 9.5 në mënyrë që të kandidohet, ky është një kriter i dhënë nga mësuesi”. Disa kritere të tjera të cituara janë: oratoria, aftësia për të përfaqësuar klasën, sjellja, përgjegjësitë e marra, etj. Një tjetër problem i hasur nga nxënësit (specifikisht, 16 prej tyre) është sevotohet duke patur parasysh shoqërinë me njëri-tjetrin dhe jo aftësitë për të përfaqësuar klasën. Në Shkollën e Mesme “Kajo Karafili”, Maminas për shkak të këtij fenomeni, mësuesit kanë zgjedhur t’i përzgjedhin vetë studentët përfaqësues duke mos i lejuar nxënësit e tjerë të votojnë sepse “do të vendosin njerëz të paafte në krye”, përgjigjet një nxënës.



Sa i përket zgjedhjes së përfaqësuesve në shkollat ku çdo klasë ka më tepër se 4 paralele, vetëm në Shkollën e Mesme “Ibrahim Muça”, Librazhd, janë marrë 9 përgjigje të cilat referojnë se nga çdo klasë zgjidhen 2 persona për t’i përfaqësuar. Nxënësit reflektojnë gjithashtu një mungesë dijeje për mënyrën se si vijohet në përzgjedhjen e përfaqësuesve në Qeverinë e Nxënësve nga të zgjedhurit e tyre. Në katër shkollat e tjera, nxënësit referojnë të mos kenë shumë njohuri për këtë procedurë, por evidentohet gjithashtu klasat nuk kanë më shumë se 4 paralele dhe procedura e veçantë e parashikuar nga Udhëzimi Nr. 28 nuk mund

të vihet në punë.

Lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të Qeverisë së Nxënësve, 81.7% e nxënësve përgjigjen se Kryetari i Qeverisë zgjidhet nëpërmjet votës së fshehtë të të gjithë nxënësve të gjimnazit, kurse 18.3% e tyre referojnë të kundërtën. Për zgjedhjen e Nënkyetarit të Qeverisë 57% e të anketuarve (143 nxënës) nuk kanë dijeni se si zgjidhet ndërkohë që vetëm 29.9 % e tyre referojnë se ai është zgjedhur. Një përqindje e njëjtë reflektohet edhe për zgjedhjen e Sekretarit të Qeverisë së Nxënësve ku 58.7% (149 nxënës) nuk kanë dijeni nëse ai është zgjedhur dhe vetë 32.7% po hojnë se një gjë e tillë ka ndodhur. 47.3% e të anketuarve nuk kanë dijeni mbi procedurën e zgjedhjes së Nënkyetarit dhe




Secrutarit, rreth 18% deklarojnë se këto pozicione përzgjidhen nëpërmjet votës së fshehtë të të gjithë nxënësve të gjimnazit dhe 34.7% deklarojnë se ata zgjidhen nga

anëtarët e Qeverisë së Nxënësve.

82.6% (209 nxënës) deklarojnë se zgjedhjet për Qeverinë e Nxënësve mbahen çdo vit në përputhje me Udhëzimin Nr.28, ndërkohë që 14.2% e nxënësve të anketuar referojnë se nuk kanë dijeni për periodicitetin e zgjedhjeve.


#### A MBAHEN ZGJEDHJET PËR QEVERINË E NXËNËSVE ÇDO VIT?



#### b. Ndërveprimi mes Qeverisë dhe aktorëve të tjerë

Ndërveprimi i Qeverisë së Nxënësve me vetë nxënësit por edhe me aktorë të tjerë është i rëndësishëm sidomos kur behët fjalë për adresimin e problematikave apo kërkesave që nxënësit mund të kenë. Për këtë është e rëndësishme që të gjithë nxënësit të kenë dijeni për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Qeverisë së Nxënësve. Nga të dhënat e anketimit rezulton se vetëm 23.7% e të anketuarëve (59 nxënës) kanë dijeni mbi detyrat e Qeverisë së Nxënësve, 27.7% referojnë që nuk kanë dijeni dhe shumica prej 48.6% (121 nxënës) kanë zgjedhur opsionin “Nuk e di”. Disa prej nxënësve kanë pohuar se detyrat e Qeverisë “janë të afishuara në hyrjen e dhomës së senatit”, “informacioni i referohet nga nxënësit përfaqësues” dhe “tek rregullorja e shkollës”.


#### A I NJIHNI DETYRAT E QEVERISË SË NXËNËSVE?




shkollës”.

Gjithashtu, 66 nxënës kanë detajuar detyrat e anëtarëve të Qeverisë së Nxënësve ku përgjigjjet më të shpeshta janë: zhvillimi i planit të aktiviteteve dhe projekteve; përcjellja dhe trajtimi i problemeve të nxënësve; informimi i nxënësve; të sigurojnë gjithëpërfshirje; të kontribuojnë në ndërtimin e një klime më pozitive dhe të përfaqësojnë zërin e nxënësve në takime.

#### A JENI NË DIJENI SE KUR KRYHEN MBLEDHJET E QEVERISË SË NXËNËSVE?




Pjesa më e madhe e të anketuarve, 58.1% prej tyre deklarojnë se kanë dijeni se kur kryhen mbledhjet e Qeverisë së Nxënësve, kurse 41.9% deklaruan të kundërtën. Gjithashtu një pjesë e konsiderueshme, 44.3% e nxënësve nuk kanë dijeni nëse këto mbledhje janë të hapura për prezencën e tyre si dëgjues, 33.2% prej tyre mendojnë se ato nuk janë dhe vetëm 22.5% pohojnë se mbledhjet janë të hapura.



Ndërkohë të rralla janë rastet kur nxënësit marrin pjesë në mbledhjet e realizuara nga Qeveria e nxënësve. 86.3% (215 nxënës) referojnë


se nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet e realizuara prej saj dhe vetëm 13.7% (34 nxënës) kanë qënë pjesëmarrës, për arsye të ndryshme ku referohen aktivitetet e planifikuara, diskutimi i problematikave të nxënësve etj.

Nxënësit u pyetën gjithashtu mbi aktorët e tjerë që marrin pjesë në mbledhjet e Qeverisë së Nxënësve. Pjesa më e madhe e të anketuarve 94 nxënës (nga 231 përgjigje) referojnë se mësuesi ndihmës merr pjesë në mbledhje, ndjekuar nga përfaqësuesit e bordit të shkollës (107 nxënës)



përfaqësues të drejtorisë (66 nxënës), përfaqësues të Këshillit të Prindërve (28), dhe më pak referohen të marrin pjesë mësues të tjerë, apo përfaqësues të OJF-ve. 59.6% e të anketuarëve referojnë se nuk janë të informuar mbi veprimtarinë e Qeverisë së Nxënësve ndërkohë që 40.4% prej tyre pohojnë se mënyrat e informimit mbi veprimtaritë janë nëpërmjet: përfaqësuesit të klasës, mësuesit kujdestar, një grupi të hapur në rrjete sociale, nga Sekretari i shkollës apo dhe nga Presidenti i shkollës.


Ndër të tjera, 74 prej të anketuarëve deklaruan se informacioni mbi aktivitetet u përcillet nëpërmjet një këndi të posaçëm në ambientet e shkollës, 159 pohojnë se informacioni përcillet nëpërmjet përfaqësuesve të paraleleve/klasave, 7 referojnë se informacioni publikohet në gazetën e shkollës dhe nën opsionin “Tjetër”, nxënësit referojnë mënyrën



alternative të përdorimit të mediave sociale, nëpërmjet mësuesit kujdestar apo Presidentit.

Sa i përket hartimit të Planit Vjetor të Qeverisë së Nxënësve, evidentohet se të anketuarit nuk kanë informacion. Nga 131 përgjigje të përpunuara, shumica prej tyre (konkretisht, 94) referojnë se nuk e dinë përmbajtjen e këtij dokumenti dhe mënyrën se si ai hartohet. Vetëm 26 nxënës kanë referuar se ai përfshin: problematikat e nxënësve, përgatitjen e raportit vjetor, zhvillimin e projekteve dhe aktiviteteve të kërkuara nga nxënësi, rregullat e shkollës, nismat në ndihmë të njerëzve me problematika të veçanta, evente të ndryshme, aktivitete në dobi të nxënësve dhe krijimin e klimës më të mirë në ambientet e shkollës,

Sa i takon kontakteve me pjesën tjetër të nxënësve, 71.4% e të anketuarve referojnë se Qeveria i




ruan kontaktet me to nëpërmjet përfaqësuesit të klasës apo takimeve periodike, të cilat variojnë: 1 herë në muaj, disa herë në muaj, 1 herë në javë, disa herë në vit.

Shumica prej të anketuarve 60.5% (138) e vlerësojnë Qeverinë si aktive në zgjidhjen e problemeve me të cilat përballen nxënësit gjatë procesit mësimor dhe edukativ, si dhe në ndërtimin e urave të komunikimit me stafin mësimor ndërkohë 29.4% (67 nxënës) e vlerësojnë si shumë aktive dhe 10.1% (23 nxënës) japin një


vlerësim negativ si pasive për Qeverinë.

c. Zhvillimi i aktiviteteve ekstra kurrikulare (jashtë


programit të shkollës) dhe plotësimi i detyrave të tjera nga Qeveria e Nxënësve



Ndër të tjera, Qeveria e Nxënësve ka një sërë detyrash që shkojnë përtej programit mësimor dhe shkollor, sicc është interaktiviteti me nxënësit për të organizuar veprimtari të ndryshme, zgjidhjen e konflikteve, ofrimin e ndihmës ndaj nxënësve në vështirësi apo në rrezik për braktisjen e shkollës apo për parandalimin e abuzimit me duhanin, alkolin apo drogat. Kështu lidhur me veprimtaritë kryesore kryesore të Qeverisë së Nxënësve, një pjesë e vogël prej të anketuarve reflektojnë të kenë dijeni për to: 60 prej të anketuarve deklaruan se Qeveria harton dhe zbaton planin vjetor, 17 pohojnë përgatitjes e raportit vjetor, 68 pohojnë për zhvillimin e veprimtarive jashtëkurrikulare nga ana e Qeverisë, 105 nxënës konfirmojnë zhvillimin e projekteve të lidhura me interesat e shfaqura nga nxënësit, 25 nxënës pohojnë zhvillimin e pyetësorëve në lidhje me kënaqësinë e nxënësve mbi shërbimet e ofruara nga shkolla, dhe vetëm 3 nxënës konfirmojnë botimin e gazetës se tyre.



Një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve prej 48.5% referojnë se Qeveria ka realizuar aktivitete mbi parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, krahasuar me 14.6% e të anketuarve të cilët pohojnë se aktivitete të tilla nuk janë zhvilluar. Ndërkohë 36.8% e nxënësve deklarojnë se nuk kanë dijeni për aktivitete të tilla.



Lidhur me vlerësimin

e nxënësve për përmbushjen e detyrave nga Qeveria e Nxënësve, të anketuarit shfaqën qendrimet e ndryshme. Kështu, nga 169 nxënës, 57 prej tyre (ose 33.7%) vlerësuan se Qeveria organizon veprimtari nëpërmjet të cilave nxënësve u jepet mundësia të dëgjohen nga drejtuesit dhe mësuesit e shkollës mbi idetë në të mirë të shkollës dhe vetes duke cituar se në aktivitete ka




gjithëpërfshirje, ndërkohë që 10 nxënës (5.9%) reflektuan një vlerësim minimal të Qeverisë për këtë aspekt duke pohuar se “organizime të tilla nuk ka patur deri në momentin e plotësimit të pyetësorit”.

Nga 162 përgjigje në total, 61 të anketuar (36.1%) vlerësuan maksimalisht organizimin e aktiviteteve në dobi të nxënësve të shkollës nga Qeveria e nxënësve duke cituar se aktivitetet më së shumti janë kryer në formën e konkurseve, ndërgjegjësimit apo gjatë festave kombëtare; ndërkohë që vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve, 5 prej tyre (3%), e vlerësuan organizimin e këtyre aktiviteteve minimalisht.

44 (27.8%) nxënës nga 158 vlerësojnë pozitivisht kontributin e Qeverisë në krijimin e një klime pozitive në shkollë, veçanërisht në zgjidhjen e konflikteve nxënës-nxënës, nxënës-mësues duke cituar se “mësuesit bëjnë gjithçka për të shmangur konfliktet” “krerët e shkollës, si dhe përfaqësuesit e nxënësve përpiqen të ndalojnë fenomene të tilla, si: dhuna fizike, psikologjike, abuzimet, diferencat racore, seksuale, fetare, etnike, etj. **por pa ndonjë rezultat**”; ndërkohë që një pjesë relativisht e vogël e nxënësve (10.7%) të anketuar nuk kanë një vlerësim pozitiv për Qeverinë në këtë aspekt duke deklaruar se “zakonisht nuk përzihen”.

Kontributi i Qeverisë në parandalimin dhe pakësimin e abuzimit të nxënësve me duhanin, alkoolin dhe drogat, si dhe të braktisjes së shkollës duke cituar zhvillimin e orëve edukative mbi këto biseda, përfshirjen e mësuesve dhe monitorimin me kamera, vlerësohet me pikët maksimale nga 56 nxënës (34.1%) nga 164 në total, ndërkohë që 42 nxënës (25.6%) vlerësojnë një nivel më të ulët përfshirjeje të Qeverisë së Nxënësve duke cituar se “nuk ka kontroll të mjaftueshëm rreth këtyre situatave” apo “ndërgjegjësojnë nëpërmjet fjalimeve, por ndalimi nuk konkretizohet, sidomos në rastin e konsumit të duhanit”.

74 nxënës (46.2%) nga 160 të përgjigjur vlerësojnë pozitivisht organizimin e ndihmës ndaj nxënësve me vështirësi në të nxënës apo me probleme sociale duke referuar se janë mësuesit ata që angazhohen më së tepërmi kurse Qeveria angazhohet në përfshirjen e tyre në rrethet shoqërore, gjithashtu vërehet angazhimi nga ana e psikologes së shkollës dhe ndihma materiale në formën e librave falas apo donacioneve; ndërkohë që për pjesën tjetër të nxënësve (46 nxënës/28.7%) niveli i angazhimit të Qeverisë në këtë aspekt është më i ulët duke pohuar se “raste të tilla nuk ka për momentin”, ndërsa nga ana tjetër 37 nxënës (23.1%) pohojnë se nuk kanë dijeni për aktivizimin e Qeverisë në këtë drejtim.




Ndërkohë që 49.8% e nxënësve pohojnë Qeveria e Nxënësve ka marrë propozime mbi aktivitete të mundshme nga nxënësit, 11.2% janë përgjigjur se propozime të tilla nuk ka patur. ndërsa 39% prej tyre nuk kanë dijeni.

Nën të njëjtën temë, 55% e të anketuarëve pohojnë se janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin se “Qeveria e Nxënësve i merr parasysh propozimet për zhvillimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare të bërë nga nxënësit” dhe vetëm 6.9% e të anketuarve shprehen aspak dakord. Qëndrime e nxënësve për sa më sipër reflektojnë një pëceptim më së shumti pozitiv ndaj ndërveprimit që Qeveria e Nxënësve ka me pjesën tjetër të trupit studentor.

Së fundmi, 57.8.2% e të anketuarëve pohojnë se janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin se “Aktivitetet e iniciuara nga Qeveria e Nxënësve kanë ndikim pozitiv në përvojën e tyre në shkollë”, dhe vetëm 10.3% prej tyre nuk bien aspak dakord me një pohim të tillë. Lidhur me këtë aspekt gjithashtu, shumica e të anketuarve kanë një opinion pozitiv mbi ndikimin e Qeverisë së Nxënësve


**QEVERIA E NXËNËSVE I MERR PARASYSH PROPOZIMET PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE EKSTRAKURRIKULARE TË BËRË NGA NXËNËSIT**

■ Aspak dakord ■ Pjesërisht dakord ■ Neutral ■ Dakord ■ Plotësisht dakord



**AKTIVITETET E INICIUARA NGA QEVERIA E NXËNËSVE KANË NDIKIM POZITIV NË PËRVOJËN TIME NË SHKOLLË.**

■ Aspak dakord ■ Pjesërisht dakord ■ Neutral ■ Dakord ■ Plotësisht dakord



përfaqësuarit e tyre.

## 6. Njohuritë dhe vlerësimi i anëtarëve të Qeverisë së Nxënësve mbi aktivitetin dhe angazhimin e Qeverisë



Përveç matjes së përceptimit të funksionalitetit dhe demokratizimit të Qeverisë së Nxënësve, nëpërmjet një pyetësi të ngjashëm, KShH mbledhi të dhëna edhe prej anëtarëve të Qeverisë së Nxënësve në 5 shkollat e targetuara nga projekti. Të dhënat e rezultuara nga anketimi janë të analizuara si më poshtë:

### Të dhëna të përgjithshme mbi të anketuarit

Të dhënat e kategorizuara për nxënësit që i janë përgjigjur anketimit, pasqyrohen në vijimësi:

#### a. Gjinia

75% e të anketuarve ose 30 prej tyre janë vajza dhe ndërsa 25% prej tyre janë djem (10), duke reflektuar kështu një prezencë më të lartë të vajzave në formimin e Qeverive të Nxënësve dhe zgjedhjen si përfaqësuese të klasave respektive. Edhe përbërja gjinore në secilën prej shkollave është në favor të vajzave duke reflektuar raportet: 8-1, 7-1, 4-2, 7-5, dhe vetëm në rastin e Shkollës “Ibrahim Muça”, Librazhd rezulton të ketë një balancë gjinore me 5 përfaqësues të secilës gjini, megjithatë zgjedhjet për përfaqësues nuk kishin përfunduar ende në momentin e anketimit.



#### b. Mosha


Të dhënat e kategorizuara sipas moshës së të anketuarve evidentojnë se pjesa më e madhe e tyre i përket grupmoshës 16 (35% e të anketuarve) dhe 17 vjecc (42.5 %) ndërkohë që 15% e të anketuarëve ishin 15 vjeç (6 individë) dhe 7.5% e të anketuarëve ishin 18 vjeç (3 individë).

#### c. Klasa

anketuarit ndahen në tre grupe kryesore ku:

- d. 32.5% e të anketuarëve janë nxënës në klasën e 10 (13 individë)


Lidhur me ndarjen sipas klasave, të



- e. 35% e të anketuarëve ishin nxënës në klasën e 11 (14 individë)
- f. 32.5% e të anketuarëve ishin nxënës në klasën e 12 (13 individë)

#### d. Qyteti/Shkolla

Lidhur me shkollën ku shkollohen të anketuarit anëtarë të Qeverisë së Nxënësve, pjesa më e madhe, 35% e të anketuarëve janë pjesë e Qeverisë së Nxënësve të Shkollës së Mesme Rrëshen




(14 individë) ndjekur nga 22.5% e të anketuarëve të cilët janë pjesë e Qeverisë së Nxënësve të Shkollës së Mesme “Asim Zeneli,, Gjirokastër (9 individë). 17.5% e të anketuarëve janë pjesë e Qeverisë së Nxënësve të Shkollës së Mesme “Kajo Karafili,, Maminas (7 individë), ndërkohë që 15 % dhe 10% e të anketuarve janë pjesë e Qeverisë së Nxënësve përkatësisht në shkollat e mesme “Ibrahim Muça,, Librazhd (6 individë) dhe “28 Nëntori,, Burrel (4 individë).

#### Vlerësimi i të anketuarëve mbi situatën

##### a. Mënyra e përzgjedhjes së nxënësve përfaqësues dhe funksionimi i Qeverisë së Nxënësve;

92.3% e të anketuarëve janë përgjigjur se Qeveria e Nxënësve në shkollën e tyre është ngritur.



Lidhur me anëtarësinë e Qeverisë së Nxënësve, në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Rrëshen, ka një mungesë unifikimi informacioni lidhur me numrin konkret të anëtarëve të Qeverisë së Nxënësve, ku nga nxënës të ndryshëm janë referuar përgjigje të ndryshme prej 8 anëtarë deri në 18 anëtarë. Ndërkohë përfaqësuesit e Shkollës së Mesme “Ibrahim Muça”, Librazhd pohojnë se Qeveria përbëhet nga 36 anëtare ose 2 përfaqësues për çdo klasë ndërsa shkolla e Mesme “Kajo Karafili”, Maminas rezulton të

ketë 6 përfaqësues në Qeverinë e Nxënësve. Gjithashtu, përfaqësuesit e Shkollës së Mesme “Asim Zeneli”, Gjirokastrë pohojnë se Qeveria përbëhet nga 10 anëtarë ndërsa përfaqësuesit e Shkollës së Mesme “28 Nëntori”, Burrel referojnë 11 ose 12 anëtarë.

Sa i përket mënyrës së përzgjedhjes së përfaqësuesve të klasave, të anketuarit reflektojnë përgjigje të ngjashme me nxënësit, ku vihet re ndihma e ofruar nga mësuesi kujdestar gjatë procesit; referimi ndaj kriterëve si mesatarja, sjellja, aftësitë drejtuese dhe komunikative; fushata e kryer nga kandidatët gjatë së cilës prezantohen programet; votimi i fshehtë dhe, pas përzgjedhjes fillestare, gara për zgjedhjen e Presidentit. Në një rast, në Shkollën e Mesme “Rrëshen”, vihet re dhe aplikimi i praktikës së mirë, sipas të cilës propozimet për përfaqësues të klasës bëhen nga vetë nxënësit dhe jo nga mësuesja, e cila përzgjedh nxënësit me mesatare më të lartë, siç evidentohet në një pjesë të rasteve të tjera.



Vetëm në Shkollën e Mesme “Ibrahim Muça”, Librazhd videntohet një rast me më tepër se 4 paralele të një klase, por dhe në këtë rast, nxënësit referojnë se procedura e zgjedhjes është e njëjtë: nxënësit votojnë për të zgjedhur 2 përfaqësues për çdo klasë, njëri prej të cilëve është senatori dhe tjetri zëvendëssenator. Ata zgjedhin të mos detajojnë nëse procedura vijohet sipas Udhëzimit të cituar më lart. Një tjetër përfaqësues nga një tjetër shkollë e mesme rezulton të ketë informacion thuajse tërësisht të saktë mbi procedurën e plotë, sipas së cilës “nëse ka më tepër se 4 paralele, zgjidhen nga **dy** përfaqësues për çdo klasë, prej të cilave zgjidhen **tre** senatorë të vitit”, ndërkohë që procedura e parashikuar nga Udhëzimi Nr. 28, datë 02.08.2013 shpreh “Kur një klasë ka më shumë se katër paralele, çdo klasë paralele, nën kujdesin e mësuesit kujdestar përkatës, zgjedh me shumicë votash **tre** nxënës, të cilët formojnë së bashku përfaqësuesit e paraleleve të një klase. Përfaqësuesit e paraleleve të një klase, nën kujdesin e një mësuesi të caktuar nga drejtori, zgjedhin me shumicë të thjeshtë votash të fshehta, **katër** anëtarë të qeverisë së nxënësve”. Gjithsesi, në katër prej shkollave të përfshira në projekt, përfaqësuesit deklarojnë se nuk ka më tepër se 3-4 paralele për klasë.



Lidhur me zgjedhjen e Kryesisë së Qeverisë, 86.8% e të anketuarëve referojnë se Kryetari/ja i/e Qeverisë zgjidhet nëpërmjet votës së fshehtë të të gjithë nxënësve të gjimnazit, kurse pjesa e mbetur e të anketuarve prej 13.2% referojnë të kundërtën.

Sa i takon zgjedhjes së Nënkyetarit/es, 52.5% e anëtarëve të Qeverisë deklarojnë se nuk është zgjedhur ende, 40% pohojnë se është zgjedhur ndërsa 7.5% nuk kanë dijeni për këtë çështje, ndërkohë që përsa i përket zgjedhjes së Sekretarit/es,


47.5% e përfaqësuesve referojnë se ai/ajo është zgjedhur, 37.5% pohojnë të kundërtën dhe 15% nuk kanë dijeni.



Të anketuarit në masën 57.9% referojnë se Nënkyetari/ja dhe Sekretari/ja janë zgjedhur nga anëtarët e Qeverisë së Nxënësve ndërsa 21.1% prej tyre referojnë se janë zgjedhur nëpërmjet votës së fshehtë të të gjithë nxënësve të gjimnazit dhe 21.2% nuk kanë dijeni. Me interes për t'u vërejtur është fakti se përgjigje të kundërta kanë ardhur nga përfaqësues të të njëjtave shkolla, ccka vërteton se ende nuk ekziston një praktikë e mirëvendosur.



Lidhur me detyrat e Kryetarit/es, Nënkyetarit/es, Sekretarit/es dhe anëtarëve të tjerë të Qeverisë, 71.1% e të anketuarëve pohojnë se ato janë të mirëpërcaktuara në një statut, rregullore apo tjetër dokument.




Ndërsa 26.3% prej tyre nuk kanë dijeni. Në rastet e përcaktimit me shkrim të këtyre detyrave, përfaqësuesit referojnë se ato janë të shkruara në: Rregulloren e Senatit/Qeverisë së Nxënësve, në "Udhëzues për krijimin dhe funksionimin e Qeverisë së Nxënësve" (dokumenti i referuar më lart në këtë raport), janë të hartuara nga mësuesit, në një dokument të afishuar në këndin

e Qeverisë së Nxënësve etj,

Sa i përket ndarjes së detyrave, përfaqësuesit vihet re se të anketuarit kanë dijeni të përgjithshme për detyrat e të gjithë përfaqësuesve duke përmendur disa prej tyre si “Kryetari i Qeverisë duhet të përmbushë me përpikmëri të gjitha detyrat e ngarkuara në të mirë të shkollës, të drejtojë me dinjitet dhe të punojë për zgjidhjen e problemeve të referuara nga nxënësit; Zëvendëskryetari referohet si krahu i djathtë i Kryetarit, i cili bën gjithashtu zëvendësimin e tij në rast mungese; Sekretari është i/e ngarkuar me përgatitjen e dokumentave, procesverbaleve dhe organizimin e mbledhjeve.


Sa i takon zgjedhjeve dhe procesit demokratik, 94.7% e të anketuarëve prej përfaqësuesve të Qeverisë së Nxënësve pohojnë se zgjedhjet për Qeverinë e Nxënësve mbahen rregullisht çdo vit, kurse 5.3% deklarojnë të kundërtën.



Mbledhjet e Qeverisë së nxënësve rezultojnë të jenë periodike, ku rezulton se 60% (29 nxënës) e pjesëtarëve të Qeverisë së Nxënësve referojnë se Qeveria e Nxënësve mban mbledhje periodike 4 herë apo më tepër çdo muaj, 3 herë në muaj ose 1 herë në muaj.


Ndërkohë 31.4% (11 nxënës) pohojnë se Qeveria e nxënësve nuk bën mbledhje periodike mujore.

Shumica e përfaqësuesve të Qeverisë, rreth 45.9% prej tyre pohojnë se përgatisin kalendar dhe agjendë për përcaktimin e mbledhjeve, 13.5% referojnë vetëm mbajtjen e një kalendari për përcaktimin e datave, ndërkohë që 5.4% e përfaqësuesve pohojnë se përgatitet vetëm agjendë për mbledhjet e caktuara. Nga ana



tjetër, një pjesë e konsiderueshme e përfaqësuesve, rreth 27% prej tyre pohojnë se nuk kanë dijeni për hartimin e këtyre dy dokumentave ndërkohë 8.1% e anëtarëve të Qeverisë deklarojnë se asnjëri prej këtyre dy dokumentave nuk mbahet.

Lidhur me dokumentimin e diskutimeve të zhvilluara në mbledhjet e Qeverive të Nxënësve,




52.6% e të anketuarëve referojnë mbajtjen e një procesverbali ku këto diskutime reflektohen ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme prej 34.2% nuk kanë dijeni dhe rreth 13.2% referojnë se procesverbale të tilla nuk mbahen aspak.

Lidhur me personin përgjegjës për moderimin e mbledhjeve të Qeverisë së Nxënësve, 21 përfaqësues (56.8% e të anketuarve) referojnë se personi përgjegjës është Kryetari/ja i/e Qeverisë, ndërkohë që po i njëjti numër nxënësish pohojnë se edhe mësuesi/ja ndihmës/e angazhohet në këtë pozicion. Gjithashtu përfaqësuesit e


Qeverisë pohojnë edhe bashkërendimin e punës nga Kryetari dhe mësuesi/ja ndihmës/e për drejtimin dhe moderimin e mbledhjeve.

Anëtarët e Qeverisë së Nxënësve pohojnë se kanë marrëdhënie të shëndetshme bashkëpunimi me njëri-tjetrin dhe më së shumti mbajnë komunikime verbale me njëri-tjetrin, si dhe përdorimi i grupeve në rrjete sociale për të mbajtur komunikimin dhe ndarë mendime me njëri-tjetrin midis mbledhjeve mbi çështjet e diskutuara apo që mbeten për t'u diskutuar.

Nga anketimi rezulton gjithashtu se Qeverisë së nxënësve i është akorduar një mjedis i posaçëm ku anëtarët ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe një gjë e tillë është pohuar nga 100% e të anketuarëve.



Sa i takon çështjeve kryesore të trajtuara në Planin Vjetor të Qeverisë së Nxënësve të anketuarit referojnë se disa prej ccështjeve janë: interesat e nxënësve, aktivitetet që do të zhvillohen (datat e tyre, tipologjia – ku më së shumti dominojnë festat kombëtare dhe ndërkombëtare, aktiviteteteve



sensibilizuese, etj.), takimet e Qeverisë së Nxënësve, programet mbi mbështetjen e nxënësve për të vijuar studimet, Në disa raste evidentohet se Plani përgatitet nga mësuesit dhe jo nga Qeveria, e cila thjesht e zbaton.


Lidhur me pjesëmarrjen e Qeverisë në vendimarrjen e shkollës, 59.5% prej të



anketuarëve referojnë se Qeveria përfshihet në hartimin e rregullores së shkollës dhe planeve afatmesëm/afatgjatë, 21.6% prej tyre nuk kanë dijeni ndërsa 18.9% e përfaqësuesve pohojnë se Qeveria nuk përfshihet në hartimin e dokumentave të tillë..

## b. Ndërveprimi mes Qeverisë dhe aktorëve të tjerë


Sa i përket ndërveprimit gjatë mbledhjeve me aktorë të tjerë, pjesa më e madhe, rreth 27




përfaqësues të Qeverisë së Nxënësve (71.1%) pohojnë se ndërveprimi kryesor është me mësuesin ndihmës i cili i bashkohet mbledhjeve të tyre, ndërkohë që aktorë të tjerë që përfshihen në mbledhjet dhe veprimtarinë e Qeverisë së

Nxënësve përfshijnë: përfaqësues të drejtorisë (pohuar nga 11 përfaqësues ose 28.9% prej tyre); përfaqësues të bordit të shkollës (pohuar nga 10 përfaqësues ose 26.3%), përfaqësues të Këshillit të Prindërve (pohuar nga 2 përfaqësues apo 5.3%), mësues të tjerë (pohuar nga 3 përfaqësues apo 7.9%). Sa i takon përfshirjes së përfaqësuesve të OJF-ve, rreth 60% e nxënësve (21 prej tyre) referojnë se organizata jofitimprurëse që zhvillojnë aktivitetin në komunitetin e tyre nuk janë ftuar të bëhen pjesë e mbledhjeve ndonjëherë, ndërkohë që 34.3% (12 nxënës) pohojnë se ka patur raste në të cilat ata janë ftuar. Në rastet e evidentuara ku ka patur përfshirje të OJF-ve, kanë qënë kryesisht organizata të cilat kanë ndihmuar në zhvillimin e aktiviteteve në komunitet, përgjithësisht organizata që punojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, kundër diskriminimit, ndihmën sociale dhe mbrojtjen e të drejtave.

Sa i takon mësuesit ndihmës, 51.4% e përfaqësuesve pohojnë se mësuesi ndihmës nuk zgjidhet nga ta, 27% prej tyre referojnë të mos kenë dijeni mbi këtë çështje dhe rreth 21.6% e tyre pohojnë është Qeveria ajo që zgjedh mësuesin ndihmës.




Sa i përket ndërveprimit me drejtorin/en e shkollës, si rezultat i anketimit evidentohet se 34.3% e tyre pohojnë se ka takime të shpeshta dy herë në muaj, 31.4% pohojnë se periodiciteti i takimeve është një herë në muaj, 8.6% e tyre pohojnë se takimet ndodhin më rrallë dhe 25.7% prej të anketuarve nuk kanë dijeni mbi këto takime. Të anketuarit pohojnë se gjatë këtyre takimeve, temat më të diskutuara janë: problemet e klasave, zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme, zgjidhja e shqetësimeve të nxënësve në tërësi dhe veçanti, mbarëvajtja e aktivitetit të shkollës, mirëmbajtja e shkollës, mbajtja e rregullit në ambientet e shkollë dhe statistikën në lidhje me




përmirësimin e shkollës si një institucion edukues.

Mbi mënyrat e përcjelljes së informacionit mbi aktivitetet e zhvilluara nga Qeveria e Nxënësve, ashtu sicc pohohet edhe në anketimin e nxënësve vërehet se edhe përfaqësuesit e Qeverisë së Nxënësve referojnë tre menyrë kryesore: 23 përfaqësues (62.2%)pohojnë se informacioni përcillet nëpërmjet një këndi të posaçëm në ambientet e shkollës, 21 përfaqësues (56.8%) deklarojnë se informacioni përcillet nëpërmjet përfaqësuesve të paraleleve/klasave dhe vetëm 1 përfaqësues (2.7%) referon gazetën e shkollës si mediumin e përdorur.




Shumica e përfaqësuesve të Qeverisë së Nxënësve pohon mbajtjen e kontakteve nëpërmjet takimeve periodike me pjesën tjetër të nxënësve, ku 40% e tyre referojnë zhvillimin e këtyre takimeve 3-4 herë në muaj, 25.7% 1 herë në muaj, 14.3% 2 herë në muaj dhe 20% pohojnë se takimet janë më informale duke referuar se “informacioni merret dhe jepet nga përfaqësuesit e klasës”, “nxënësit janë në dijeni për anëtarët dhe nëse kanë problematika e kërkojnë vetë takimin”, “në bazë të aktiviteteve, çështjeve dhe problematikave të ndryshme” apo “sa herë është e nevojshme”.



**SA AKTIVE ËSHTË QEVERIA E NXËNËSVE NË ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE ME TË CILAT PËRBALLEN NXËNËSIT GJATË PROCESIT MËSIMOR DHE EDUKATIV SI DHE NDËRTIMIN E URAVE TE KOMUNIKIMIT ME STAFIN MESIMOR?**

■ Shumë aktive ■ Aktive ■ Pasive




Në ndryshim të gjetjeve prej anketimit të nxënësve, përfaqësuesit e Qeverisë së Nxënësve në masën prej 64.9% të të anketuarëve referojnë se Qeveria është shumë aktive në zgjidhjen e problemeve me të cilat përballen nxënësit gjatë procesit mësimor dhe edukativ, si dhe ndërtimin e urave të komunikimit me stafin mësimor. Ndërkohë pjesa tjetër prej 35.1% e të anketuarve kanë mendojnë se Qeveria është “aktive” dhe ndërkohë asnjë prej përfaqësuesve nuk mendon se veprimtaria e Qeverisë është “pasive”.

**c. Zhvillimi i aktiviteteve ekstrakurrikulare (jashtë programit të shkollës) dhe plotësimi i detyrave nga Qeveria e Nxënësve.**

Lidhur me veprimtaritë kryesore që Qeveria e Nxënësve ndërmerr sipas përfaqësuesve të saj referohet të jenë: hartimi dhe zbatimi i planit vjetor (pohuar nga 16 nxënës), përgatitja e raportit

**VEPRIMTARITË KRYESORE QË QEVERIA E NXËNËSVE E SHKOLLËS TUAJ NDËRMERR**


■ Veprimtaritë kryesore që Qeveria e Nxënësve e shkollës tuaj ndërmerr



vjetor (referuar nga 6 prej të anketuarve), organizimi i veprimtaritë jashtëkurrikulare (pohuar nga 12 të anketuar), projektet e lidhura me interesat e shfaqura nga nxënësit (pohuar nga 29 të anketuar), zhvillimi i pyetësorëve në lidhje me kënaqësinë e nxënësve mbi shërbimet e ofruara

**A KA ZHVILLUAR QEVERIA E NXENESVE AKTIVITETE MBI PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TE DHUNSHEM?**

■ Po ■ Jo ■ Nuk e di



nga shkolla (pohuar nga 6 të anketuar).

Lidhur me aktivitetet mbi parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, 70.3% prej të anketuarëve pranojnë se janë angazhuar në zhvillimin e tyre, ndërkohë që 27% e të anketuarve referojnë se nuk janë angazhuar në aktivitete të tilla.

Kur u pyetën mbi vlerësimin e tyre për nivelin e aktivizimit të Qeverisë nga 1 (niveli më i ulët) deri në 5 (niveli më i lartë), vlerësimet kanë qënë kryesisht pozitive dhe të anketuarit u përgjigjën si më poshtë:

Shumica e përfaqësuesve të Qeverisë së Nxënësve, 15 prej tyre (51.7%), vlerësuan në nivelin më të lartë se Qeveria parashtroi shqetësimet për mbrojtjen e të drejtave të nxënësve të shkollës dhe propozimet për mbarrëvajtjen e shkollës te drejtori i shkollës, këshilli i mësuesve, këshilli i prindërve dhe bordi i shkollës duke argumentuar se “ka qënë shumë aktive duke u angazhuar në debate të ndryshme mbi këto çështje”; 11 të anketuar (37.9%) e vlerësojnë me 4 duke deklaruar se Qeveria merrej vetëm me problematikat që ndodhin dhe jo me parandalimin e tyre; 4 nxënës (13.7%) e vlerësojnë aktivizimin e Qeverisë në këtë drejtim me 3 duke referuar se “diskutimet fillimisht kryhen me mësuesen kujdestare e, ndërkohë që numri i nxënësve që e vlerësojnë negativisht këtë aspekt të Qeverisë është i ulët..

Sa i takon botimit në gazetën e shkollës të aktiviteteve të Qeverisë, 6 nga 24 përfaqësues të përgjigjur (25%) vlerësuan maksimalisht botimin në gazetën e shkollës duke pohuar se “shkolla ka gazetën e saj ku përmbledhen aktivitetet, krijimet letrare, etj”, ndërkohë që një pjesë e madhe të anketuarve, 10 prej tyre (41.6%) kanë dhënë një vlerësim minimal duke argumentuar se “gazeta botohet vetëm një herë në vit”, ndërkohë që në pjesën më të madhe të rasteve, të anketuarit deklarojnë se shkolla nuk ka një gazetë të sajën.


Vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve, 8 nga 22 prej tyre (36.3%), vlerësuan maksimalisht angazhimin e Qeverisë në bashkëpunimin me qeveri homologe nxënësish për organizimin e veprimtarive të përbashkëta duke specifikuar olimpiadat në bashkëpunimin me gjimnazet fqinje, ndërkohë që pjesa tjetër e përfaqësuesve e kanë vlerësuar këtë aspekt me më pak pikë duke evidentuar edhe vështirësi në organizimin e aktiviteteve në bashkëpunim me shkolla të tjera të mesme për shkak të pandemisë.

Së fundmi, 10 nga 21 përfaqësues të përgjigjur (47.6%) kanë vlerësuar maksimalisht aktivizimin e Qeverisë në drejtim të komisionit të etikës dhe sjelljes së shkollës dhe çdo organizimi tjetër për çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund të shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral të nxënësit në mjediset e shkollës duke argumentuar se “raste të tilla nuk kanë patur, por janë në dijeni mbi të qënurit sistem funksional”.

Lidhur me kërkesat e nxënësve për aktivitete, 68.8% e përfaqësuesve të Qeverisë së Nxënësve deklarojnë se në shkollën e tyre ka patur propozime nga nxënësit


**NË DIJENINË TUAJ, A KA PATUR  
PROPOZIME PËR AKTIVITETE NGA  
NXËNËSIT PËRKUNDREJT QEVERISË  
SË NXËNËSVE?**

■ Po ■ Jo ■ Nuk e di




për organizimin e aktiviteteve ndërkohë që 6.3% e tyre deklarojnë se të tilla propozime nuk ka patur.

Nga të anketuarit përfaqësues të Qeverisë së Nxënësve, 37.5% dhe 46.9% e tyre respektivisht pohojnë respektivisht se janë plotësisht dakord dhe dakord me pohimin “Qeveria e Nxënësve i merr parasysh propozimet për zhvillimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare të bëra nga nxënësit”, Rreth 9.4% e të anketuarve deklarohen pjesërisht dakord dhe 6.3% prej tyre neutral. Asnjë prej të anketuarëve nuk ka pohuar të jetë “aspak dakord”.



Gjithashtu, 59.4% e të anketuarëve janë deklaruar plotësisht dakord me pohimin se “Aktivitetet e iniciuara nga Qeveria e Nxënësve kanë ndikim pozitiv në përvojën time në shkollë”, 21.9% pohojnë se janë dakord me pohimin, dhe nga 9.4% respektivisht deklarohen neutralë dhe pjesërisht dakord.



## 7. Rekomandime

Të anketuarit në pesë shkollat e mesme të Republikës së Shqipërisë shprehin gjerësisht zbatimin e disa praktikave të mira në lidhje me përzgjedhjen e përfaqësuesëve në Qeverinë e Nxënësve. Nga ana tjetër, niveli i demokratizimit të brendshëm të strukturave përfaqësuese të trupës studentore në shkolla mbetet problematic dhe ka nevojë për përmirësime të mëtejshme, sidomos në drejtim të evitimit të ndërhyrjeve të personave të tjerë si mësuesit kujdestarë për caktimin e përfaqësuesve të klasave. Ndërkohë që qëndron nevoja për të përmbushur parashikimet e Udhëzimit Nr. 28, datë 02.08.2013, është gjithashtu e nevojshme të mbahet parasysh së Udhëzimi parashikon një standard minimum sa i takon përfshirjes e funksionimit të kësaj strukture , prandaj vetë shkollat duhet të promovojnë dhe nxisin nisma që marrim në konsideratë interesin më të lartë të nxënësve.

Praktikat e mirëvendosura të përfaqësimit demokratik për të zgjedhurit dhe zgjedhësit shërbejnë jo vetëm për të ndërtuar një mjedis më të shëndetshëm brenda institucionit të arsimit, por edhe për të edukuar nxënësit mbi procedurat demokratike në nivel shtetëror.

Nën këtë kuadër për të konkretizuar përmirësime të mëtejshme në mënyrën e veprimit të kësaj strukture në të gjitha institucionet e arsimit të mesëm të lartë në territorin e Shqipërisë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit parashtron rekomandimet në vijim:

- i) Mënyra e referuar nga nxënësit për përzgjedhjen e kandidaturave për përfaqësues të klasës vlerësohet të jetë tepër nën varësinë e mësuesit kujdestar të klasës. Sugjerohet që **kriteret për ofrimin e kandidaturës të hartohen nga Qeveria e Nxënësve në bashkëpunim me strukturat e tjera të brendshme dhe në diskutim me nxënësit e tjerë si dhe të bëhen publike** për të gjithë nxënësit, në mënyrë që të interesuarit, në përputhje me karakteristikat e kërkuara, të vetëofrohen për të kandiduar. Gjithashtu, sugjerohet që të evitohet praktika e referimit të kandidatëve dhe, më pas, përzgjedhjes nga mësuesi kujdestar duke u bazuar në nivelin e tyre të angazhimit në procesin mësimor duke qënë se mund të konsiderohet si diskriminim ndaj nxënësve të tjerë dhe si pengesë ndaj ushtrimit të proceseve demokratike të kandidimit dhe përzgjedhjes së lirë;
- ii) Është e rëndësishme që për të siguruar një proces sa më demokratik, të realizohen **fushatat nga kandidatët** për përfaqësues të nxënësve në të gjitha institucionet arsimore. Gjithashtu, një aspekt i rëndësishëm i një procesi të tillë është dhe **votimi i fshehtë** për të zgjedhur përfaqësuesin/en e klasës në Qeverinë e Nxënësve, për të cilin mësuesit duhet të jetë promotorët kryesorë dhe jo penguesit e këtij procesi, sicc ka rezultuar gjatë anketimit;
- iii) KShH sugjeron gjithashtu që Qeveritë e Nxënësve të jenë më aktive në **krijimin e hapësirës për aplikimin e demokracisë së drejtpërdrejtë**,.. Aspekte të tilla mund të përmbushen duke zhvilluar forume të hapura periodike midis nxënësve

dhe përfaqësuesve të ndryshëm të Qeverisë, zhvillimit të mbledhjeve të hapura për nxënësit (si më lart), zhvillimi i takimeve me përfaqësues të drejtorisë dhe strukturave të tjera vendimmarrëse për mbarëvajtjen operacionale, por jo vetëm, të shkollës;

- iv) Gjithashtu KShH evidenton nevojën për të krijuar një **metodë të formalizuar të njoftimit** mbi vendimet e marra dhe diskutimet e kryera nga përfaqësuesit në Qeverinë e Nxënësve. Sugjerohet të përdoren afishime apo botime periodike të procesverbaleve e dokumentave të tjerë të mbajtur gjatë mbledhjeve të kryera, në një vend të aksesueshëm për të gjithë nxënësit. Gjithashtu, rekomandohet njoftimi paraprak për **kryerjen e mbledhjeve të hapura** për të siguruar prezencën e nxënësve të tjerë të shkollës si dëgjues apo, në rastin e njëres prej praktikave të mira të ofruara gjatë anketimit, si votues në bazë të karakterit të mbledhjes (p.sh. zhvillimi i një aktiviteti të caktuar);
- v) Lidhur me sa më sipër, sugjerohet e nevojshme që takimet dhe mbledhjet e Qeverisë së Nxënësve të formalizohen nëpërmjet krijimit të një **draft programi (agjende) dhe mbajtjen e procesverbaleve** përkatëse në çdo rast, për të siguruar përcjelljen më të plotë të informacionit tek të përfaqësuarit - nxënësve të tjerë të shkollës - nëpërmjet medimeve të komunikimit;
- vi) Për të siguruar **periodicitetin e mbledhjeve të Qeverisë së Nxënësve**, gjithashtu sugjerohet mbajtja e një kalendari me datat e përcaktuara të mbledhjeve dhe çështjet potenciale të diskutimeve;
- vii) Rritja e **njohurive më të thellura të nxënësve në lidhje me përfaqësuesit e tyre në Qeverinë e Nxënësve** dhe ndarjen e detyrave mes tyre. Nisur nga qëndrimet e të anketuarëve vihet re në masë mbajtja e kontakteve nëpërmjet përfaqësuesit të klasës mbi çdo detyrë të mbuluar nga Qeveria e Nxënësve. Në këtë drejtim, vlerësohet pozitivisht që përfaqësuesi i klasës të luajë rolin e tij si “zëri” i të përfaqësuarëve të tij/saj, por sugjerohet si e nevojshme që vetë nxënësit të kenë njohuri të mjaftueshme mbi përfaqësuesit e tyre dhe detyrave të tyre gjatë përfaqësimit të nxënësve;
- viii) Në zbatim të Udhëzimit Nr. 28, **përzgjedhja e drejtpërdrejtë e Kryetarit/es të/së Qeverisë së Nxënësve** duhet të zbatohet në çdo rast. Duke qënë se **Nënkryetari/ja dhe Sekretari/ja** nuk janë pozicione të domosdoshme për t’u zgjedhur nëpërmjet votës së fshehtë të të gjithë nxënësve të gjimnazit, qëndron e nevojshme që të ndërtohet një praktikë e mirëvendosur mbi zgjedhjen e tyre. Nëse përzgjedhja do të kryhet nga anëtarët e Qeverisë, sugjerohet që nxënësit të njihen me personat mbajtës të këtyre pozicioneve të rëndësishme ekzekutive për të patur mundësinë e zhvillimit të kontakteve të drejtpërdrejta me ta;
- ix) **Funksionalizimi i gazetës së shkollës** mbetet një sfidë për t’u realizuar nga institucionet e edukimit të mesëm të lartë në Republikën e Shqipërisë. Gazeta nuk është vetëm një medium argëtues për nxënësit, por dhe një mënyrë e rëndësishme



për të marrë komunikime nga Qeveria e Nxënësve mbi aktivitetet, diskutimet e vendimet të cilat prekin jetën shkollore të nxënësve të realizuara gjatë periudhës ndër-botime.

- x) Sugjerohet aktivizimi i mëtejshëm i Qeverisë në **ndërtimin e një klime pozitive**, luftën kundër diskriminimit dhe fushatat sensibilizuese mbi ndalimin e abuzimit me substanca të dëmshme për shëndetin e të rinjve apo braktisjen e studimeve, duke qënë se vihet re një numër i konsiderueshëm nxënësish të cilët vlerësojnë angazhimin e Qeverisë, por nuk shohin rezultate konkrete në këtë drejtim;
- xi) Në zbatim të Udhëzimit Nr. 28, sugjerohet të zbatohet **praktika e përzgjedhjes (dhe zëvendësimit, sipas procedurës) të mësuesit ndihmës të Qeverisë së Nxënësve** nga vetë Qeveria, në varësi të kapaciteteve dhe mundësisë së secilit institucion për ta zbatuar këtë udhëzim duke marrë në konsideratë kapacitetet e limituara të burimeve njërëzore;
- xii) Sugjerohet gjithashtu që përfaqësuesit e drejtorisë dhe mësuesit të lejojnë më tepër fushëveprim për anëtarët e Qeverisë së Nxënësve sa i takon **hartimit të Planit Vjetor, rregullores së shkollës dhe planeve afatmesëm/afatgjatë e dokumentave të tjerë udhëheqës** gjatë punës së tyre, si dhe të angazhohen në zhvillimin e takimeve periodike dhe vendimmarrjen si struktura bashkërenduese në drejtimin strategjik e operacional të institucionit të edukimit;
- xiii) Duke marrë në konsideratë rolin e Qeverisë së Nxënësve sa i takon organizimit të aktiviteteve të ndryshme në dobi të nxënësve, KShH sugjeron që Qeveria të ketë një rol proaktiv dhe të përfshijë gjatë aktiviteteve në shkollë edhe përfaqësues të komunitetit apo OJV-ve, si dhe të zgjerojë spektrin e temave të trajtuara në shkollë duke përfshirë edhe aktivitete kundër ekstremizmit të dhunshë dhe radikalizmit të të rinjve në shkolla.